



REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

MARS 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



↙ Hap dyert Qendra Multifunkionale e Vjosës në Përmet

U hap Qendra e parë multifunkionale në brigjet e Vjosës, që do të shërbejë për kërkim shkencor, edukim mjedisor dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Parkun Kombëtar.



Firmoset marrëveshja mes Ministrisë së Mjedisit dhe UBT ↘

U formalizua bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës përmes një Memorandumi Mirëkuptimi, duke e kthyer partneritetin ekzistues në një bashkëpunim të strukturuar dhe afatgjatë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

↙ Pranvera ka sjellë fluksin e turistëve në Ujërat Termale të Bënjës

Zona e transformuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bashkëpunim me AKZM dhe Bashkinë Përmet, ka nisur të mirëpresë turistë dhe, pas përfundimit të investimit, do të ofrojë hapësira për vizitorë, evente, parkim, kamperë dhe promovimin e produkteve lokale, nën menaxhimin e AKZM.



Zhvillohet takimi me përfaqësues të industrisë së çelikut dhe aluminit ↘

U diskutua ndikimi i CBAM me industrinë e çelikut dhe aluminit, duke evidentuar sfidat për konkurrueshmërinë; ndërkohë, Ministria ka nisur komunikimin me Komisionin Evropian dhe ka përfunduar kuadrin për monitorimin e emetimeve, duke parashikuar një grup të përbashkët teknik me industrinë.

➤ Prezantohet Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Cilësinë e Ajrit

Strategjia përcakton vizionin afatgjatë, ndërsa Direktivat e Planit të Implementimit ofrojnë masa konkrete me afate dhe përgjegjësi të qarta. Cilësia e ajrit mbetet çështje shëndetësore dhe objektiv teknik për anëtarësimin në BE.



Zhvillohet takimi konsultativ mbi Direktivën për Shkarkimet Industriale

Në kuadër të reformave të Kapitullit 27, prezantuar për sektorin industrial dhe partnerët ndërkombëtarë Planin Specifik të Zbatimit. Qëllimi është orientimi i Shqipërisë drejt prodhimit më të pastër, duke përdorur standarde të larta mjedisore dhe Teknikat më të Mira të Disponueshme (BAT) sipas acquis të BE-së.

➤ Takim me operatorët e rafting që zhvillojnë aktivitetin në lumin e Vjosës

Në tryezën me Kryetaren e Bashkisë Përmet, diskutuan nevojat dhe sfidat e operatorëve të rafting, duke propozuar zgjatjen e sezonit dhe shtimin e vendqëndrimeve përgjatë lumit. U dakordësua që operatorët do të lidhin marrëveshje me Zyrën e Vjosës për tarifat mujore, duke krijuar një kuadër të organizuar për aktivitetin, me sezon që fillon më 1 prill.



Mblidhet Këshilli Kombëtar i Faunës

Në fokus u vendos zbatimi i Ligjit për Gjuetinë, duke diskutuar hapat për efektivizimin e tij në terren. Me shoqatat e mjedisit, gjuetarët dhe ekspertët e Ministrisë së Mjedisit, u trajtuan aktet nënligjore, Programi Kombëtar i Zhvillimit të Gjuetisë, menaxhimi i zonave dhe krijimi i një sistemi të drejtë dhe transparent tarifash.

➤ Mblidhet e Komiteti Drejtues i programit #EU4Nature

#EU4Nature forcon menaxhimin e zonave të mbrojtura përmes kuadrit ligjor dhe investimeve të rinj si energji e re për mbrojtjen e natyrës. Takimi theksoi natyrën dhe biodiversitetin si përgjegjësi ndaj brezave të ardhshëm.



➤ Vendoset sinjalistika e re për Parkun Kombëtar të lumit Vjosa

Parku Kombëtar i Lumit Vjosa, me mbi 12,7 mijë hektarë, është një pasuri natyrore unike. Sinjalistika e re ndihmon vizitorët të orientohen, të zbulojnë shtigjet kryesore dhe të mësojnë mbi biodiversitetin dhe rëndësinë e mbrojtjes së lumit të egër.

➤ Zhvillohet takimi i Komitetit Teknik me partnerët francezë të FASEP

Hodhëm hapat e parë për studimin e fizibilitetit në Tiranë-Durrës, Fier dhe Elbasan, duke analizuar sfidat dhe nevojën për zgjidhje të qëndrueshme. Synimi është menaxhimi efikas i mbetjeve sipas standardeve të BE-së, duke kombinuar riciklimin, trajtimin e organikëve, landfille sanitare dhe teknologjitë e rikuperimit të energjisë.



➤ "Simbiozë" hapi dyert në zemër të kryeqytetit

Kubi #InNature në Piramidën e Tiranës solli natyrën shqiptare në zemër të qytetit! Ekspozita prezantoi bimët endemike shqiptare dhe krijimtarinë e artizanëve të frymëzuar nga to, duke u shfaqur përmes artit dhe fotografisë. Një udhëtim unik mes natyrës dhe kreativitetit!

↙ Takimi i dytë të Komitetit Drejtues të #ALBAdapt

Programi për Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike për 2026 fokusohet në modernizimin e shërbimeve, përmirësimin e informacionit klimatik, sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe avancimin e planeve të adaptimit në 13 bashki.



Korçë
173 mijë vizitorë

Durrës
59 mijë vizitorë

Fier
51 mijë vizitorë

↘ Cilat janë parqet kombëtare më të vizituara?

Në janar-shkurt, destinacionet kryesore ekoturistike dhe zonat e mbrojtura në Korçë, Durrës dhe Fier kanë tërhequr mijëra vizitorë, duke treguar se turizmi i qëndrueshëm po e kthen natyrën e Shqipërisë në një burim zhvillimi për komunitetet lokale.

↙ 2000 fidanë të rinj i janë shtuar habitateve të Parkut Natyror të Qafështamës

Shtimi i sipërfaqeve pyjore është pjesë e vazhdueshme e punës sonë, por në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve ky kontribut nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura merr një vlerë dhe domethënie edhe më të veçantë.




↘ Agjencia Kombëtare e Pyjeve mirëpret #EXPOFOREST2026

Ekspozita është një udhëtim në kohë dhe dije mbi pasurinë pyjore, që sjell për publikun dokumente, studime dhe të dhëna të rëndësishme të hartuara ndër vite nga ish Instituti i Pyjeve dhe Kullotave, si edhe instrumente historike të matjeve pyjore dhe materiale të rralla arkivore.



U zhvillua takimi i parë monitorues me Komisionin European për Kapitullin 27

Në Ministrinë e Mjedisit, Grupi Negociator Ndërinstitucional i Punës u mbledh në një tryezë të përbashkët pune me strukturat e BE për të avancuar procesin e integritimit. Diskutimi u fokusua te progresi konkret dhe hapat që po ndërmarrim për përmbushjen e piketave mbyllëse, me theks të veçantë te hartimi i Planit të Veprimit si një instrument kyç në këtë proces.



Menaxhimi i mbetjeve dhe sezoni turistik 2026

Në mbledhjen e përbashkët të Komisioneve Parlamentare në Sarandë, zëvendësministri Genti Gazheli theksoi rëndësinë e zbatimit të ligjit për Menaxhimin e Mbetjeve si një hap i rëndësishëm drejt një Shqipërie më të pastër drejt BE.